

LUAN MALLTEZI**SHASI
(SUACIUM, SVACIUM, SUVACIUM, SOACIUM, SVAÇ)
NË SHEK. XIV-XV**

Shasi përmendet në burimet historike në vitin 1067 si ipeshkvi nga papa Aleksandri II¹. Ipeshkvia e Shasit sikundër ajo e Shkodrës, Ulqinit, Drishtit, Pultit, Arbërit, pati vartësi kishtare të ndryshme prej Tivarit dhe Raguzës, kur këto përplaseshin në shek XI-XII për primat mbi kishën katolike.

Shasi ka qënë nën Bizantin dhe më pas nën serbët ortodoksë, por me këta të fundit duket se nuk ka pasur marrëdhënie të mira për shkak të konfesionit të tij katolik. Këtë situatë dëshmon dokumenti i lëshuar nga papa Benedikt IX më 18 nëntor 1303, kryepeshkëvit të Tivarit që ushtronte drejtimin e kishës katolike. Papa e ngarkonte atë të reformonte tek besimtarët e tij katolikë sjelljet “jo të mira” që ishin përhapur “në Arbëri, Pult, Kandavi, Durrës, Kotorr, Ulqin, Shas, Shkodër, Drisht, Tivar, të cilët ishin nën sundimin e perandorit bizantin Andronik, të mbretit serb Urosh, të vëllait të tij Stefan dhe të nënës së tyre, Helenës². Këto marrëdhënie me kohë u bënë më të ashpra.

Kryepeshkvi i Tivarit, Gulielm i Adës, në një relacion të tij drejtuar më 1332 Dukës së Burgonjës, Filipit VII Valua, bënte të ditur, se banorët katolikë të dioqesës së tij hiqnin shumë nga sundimi që ushtronin serbët ortodoksë.

Ipeshkvi njoftonte se serbët, kishin vënë taksa të rënda mbi banorët katolikë të dioqezës, se ata rrihnin dhe poshtëronin klerin e tyre, mbanin në burg të lidhur në zinxhirë ipeshkvët dhe abatët dhe shpronësonin fisnikët nga pronat e tyre. Secili nga banorët e dioqezës së tij - shkruante

¹ *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia* (më tej: *A. Alb.*) Collegerunt et digesserunt Dr. L. de Thalloczy, Dr. C. Jireček, Dr. E. de Šufflay. Vindobonae, 1913, vol.I, dok.63.

² *Po aty*, 554.

ipeshkvi - ishte i gatshëm të konsakronte duart në gjakun e sllavëve po të shihnin ndonjë princ të nisur nga Franca që do të vinte tek ata”³.

Pas vdekjes së car Stefan Dushanit (1356), Shasi kaloi nën Balshajt, por sundimi i këtyre të fundit nuk vazhdoi gjatë për shkak të situatës së vështirë që u shkaktua nga sulmet që ndërmorën osmanët për pushtimin e vendit. Zotërinjtë shqiptarë u përpoqën t’i bënin ballë turqve me forcat e veta por dështuan. Ata dështuan edhe kur ndërmorën një koalicion të përbashkët ballkanik kundër tyre siç ishte Beteja e Kosovës (1389).

Pas disfatës zotërinjtë shqiptarë filluan t’i lëshonin Republikës së Venedikut qytetet e bregdetit. Më 1392 Karl Topia i dorëzoi Durrësin, më 1393 Dukagjinët i dorëzuan Lezhën. Më 1396 edhe Gjergji II Balsha u detyrua t’u dorëzojë Shkodrën dhe Drishtin. Këto ngjarje përfshinë edhe Shasin i cili ndodhej afër rrjedhjes së Bunës, 10 km pranë Shkodrës.

Qyteti i Shasit, mbante në burimet e kohës, emrin latinisht “Suacium, Svacium, Suvacium, Soacium”. Emri i saktë latinisht ka qënë “Suacium”. Ky është emri i qytetit në një monedhë të emtuar në shek. XIV.⁴

Qyteti sot është i braktisur dhe i shkretë.

Një përshkrim me vlerë për këtë qytet të lënë në harresë jep konsulli austriak Theodor Ippeni. “Prej Bune - shkruan ai - duhej afërsisht një gjysëm ore për t’iu ngjitur kodrës përpjetë e për të mbrritur poshtë liqenit, ku ndodheshin në një kodrinë në bregun e majtë të tij shtëpitë dhe kishat e vendbanimit”.

Qyteti i vjetër shtrihej mbi majën e kodrës. Ai kishte një portë në rrëzë të saj në afërsi të liqenit, një portë e dytë ndodhej në anën tjetër përballë fshatit të sotëm”⁵. Kisha e qytetit me këmbanoren e tij dukej që prej së largu.

³ “Të gjithë këta popuj të lartpërmendur, si latinët dhe arbëreshët janë shtypur keq nga zgjedha e padurueshme dhe tepër e rëndë e sundonjësve të urreyer dhe të vështirë të sllavëve. Kleri është përbuzur dhe poshtëruar, peshkopët dhe abatët shpesh herë burgosen, bujarët shpronësohen dhe mbahen në burg, kisha si katedralet ashtu edhe kolegialet janë grabitur dhe varfëruar”. *Monuments pour l’histoire des province de Namur*. V. IV, f. 293-299, (cituar nga *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, vëll.2, dok. 68, Tiranë, 1962, f.111); S.Metais, *Histori e Shqiptarëve nga ilirët deri te pavarësia e Kosovës*, Tiranë, 2006, f. 249.

⁴ O.Schmitt, *Arbëria Venedike, 1392-1479*, Tiranë, 2007, f. 96.

⁵ Th. Ippen, *Alte Kirchen und Kirchenruinen in Albanien*, I, f.235-236.

Shasi shtrihej në një zonë me kushte natyrore të buta që i jepnin dorë zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë së gjithë rajonit. Afër Shasit kishte që atëhere një varg fshatrash të lulëzuar; në bregun e djathtë të Bunës ndodhej fshati Rrushkull, më tej, në lindje, Gramshi, dhe më pas Trushi i Sipërm e Trushi i Poshtëm. Në veri të Rrushkullit ndodhej Vau i Shën Todrit. Vau kalohej me pagesë, e cila shkonte në dobi të ipeshkvisë.⁶

Pas Shën Todrit ndodhej kisha e shën Mërisë së Goricës dhe më tej kisha e Shën Todrit⁷. Midis Goricës dhe manastirit benediktin të Shën Shirgjit e Bakut, lumi kalon fshatrat Dajç dhe Samrisht. Prej aty shiheshin kodrat para Shkodrës lartësitë e Anamalit 150 m të lartë me fshatin Oblik, dhe prapa tij Taraboshi 600 m i lartë.

Përballë shtrihet vargu kodrinor i Bërdicës⁸ që shkon deri në qytetin e Shkodrës. Prapa Samrishtit me anije mund të kalohet në Obot dhe që këtej në manastirin e Shirgjit.

Shirgji ishte një nga tregjet e rëndësishme të kohës. Aty vinin tregtarë të shumtë të huaj nga Raguzi dhe Venediku. Këta kishin këtu agjentët e tyre të cilët ishin në lëvizje të vazhdueshme me mushka e kuaj të ngarkuar me kripë që niseshin drejt Kosovës duke kaluar nëpër doganën e Danjës.

Në Shirgji vinin karvane të ngarkuara me plumb e argjend që niseshin nga minierat e Kosovës⁹. Në mesjetën paraosmane, në Shirgji, mbahej çdo vit një panair i madh, ku merrnin pjesë tregtarë të shumtë.

Shasi shtrihej në një zonë që kishte lidhje tregtare të rëndësishme me vendin për rreth.

Rruga kryesore në tregtinë e kohës kalonte në Danjë. Këtu mblidheshin rrugët që vinin nga Tivari, Ulqini, Shkodra dhe Lezha.

Nga Shkodra duheshin dhe dy orë e gjysëm për të ecur derisa të kapej rruga për në Kosovë, e cila quhej në dokumentet e kohës “via schiavanescha”. Kjo rrugë nisej nga Danja.

Një rol me rëndësi në jetën ekonomike të qytetit të Shasit luante liqeni i tij që derdhej në Bunë pranë fshatit Shën Gjergj (S.Georgio).

⁶ J.Valentini, *Acta Albania Veneta*, XVIII, 4803.

⁷ Th.Ippen, *Scutari und die nordalbanische Kustenebene*, Sarajevo, 1907, 7.

⁸ Nga serbishtja “Brdo”, kodër.

⁹ O.Schmitt, *vep. e përm.*, f. 27-28.

Këtu, Buna, sic thuhej, arrinte një gjerësi të ngjashme me të Tiberit¹⁰. Liqeni ishte i pasur me peshq. Burimet njoftojnë se në dimër ai mbulohej me “rosa, lejlekë, e zogj të tjerë”¹¹.

Shasi si vendbanim lindi në mesjetë pas rënies së qytetit të vjetër të Dioklesë. Qyteti u godit nga tërmeti i rëndë i vitit 518 dhe u shkatërrua përfundimisht në shek VII¹².

Bashkë me Shasin, përreth u ngritën edhe një varg qendrash të vogla tregtare si Danja, Sarda, Shati Sapa, Balëza.

Shasi dallonte nga qytetet e mëdhenj të vjetër të vendit si: Shkodra, Ulqini dhe Tivari. Këto qytete realizonin shkëmbime tregtare në pellgun e Adriatikut duke vendosur kontakte dhe lidhje të drejtpërdrejta tregtare mes tyre. Përkundrazi në Shas, Danjë, Sardë, Shat, Sapë, Balëz, lidhjet realizoheshin vetëm nëpërmjet rrugëve tokësore.

Këto qytete ishin të vegjël dhe luanin rolin e qendrave lokale të krahinës. Aty vinin për të shitur prodhimet e tyre bujqësore fshatarët e rrethinës. Një pjesë e këtij prodhimi kalonte në duart e tregtarëve vendas e të huaj, të cilët i kalonin si mallra për t’u shitur në tregjet e tjera të vendit në Shkodër, Ulqin, Tivar, Drisht etj.

Shasi ishte qytet i mbyllur me kështjellën e vet dhe muret rrethuese. Në qytet ndodhej selia ipeshkvnore, manastiri, kishat, rezidenca e ndonjë nëpunësi (zhupan, vojvode), shtëpitë e banorëve të qytetit etj.

Shasi përmendet në burimet e kohës si “komunë”.

“Komuna” quheshin qytetet e vjetër të bregdetit dalmat, si: Ragusa, Spliti, (Spalato), Zara (Jadera) etj. Komunat kishin organe të brendshme bashkiake që qeverisnin mbi bazën e statuteve dhe zakoneve të vjetra të qytetit. Një rol të rëndësishëm luanin gjykatësit dhe noterët e komunës.

Burimet për Shasin nuk japin të dhëna të tilla. Ata sinjalizojnë se Shasi e mbështeste zhvillimin e tij në “zakonet” dhe traditat e veta mesjetare.

Shasi dallonte që nga shek.XII si qendër kishtarë.

Roli i klerit ishte i ndjeshëm brenda dhe jashtë komunitetit. Prania e klerit kishtë lënë gjurmë në ndërgjegjen e pasardhësve. Kjo shpjegon

¹⁰ C.Jireček, *Geschichte der Serben*, I-II, Gotha 1911-1918, 211 vv; O.Schmitt, *vep. e përm.*, f. 86.

¹¹ Bizzi 88.

¹² M. Šufflay, *Povijest Sjevernih arbanasa. Srbi i Arbanasi*, Botimi shqip: *Serbët dhe Shqiptarët*, “Rilindja”, Prishtinë, f. 27-28.

faktin pse kleriku i shek XVII, Marin Bici, thotë në shkrimet e tij se në Shas kishte pasur 365 kisha¹³.

Klerikët kishin një formim të mirë në shkencat humane të kohës. Për një formim të tillë bën fjalë ipeshkvi i Shasit, “zoti Pjetër”, që ndodhej në Republikën e Raguzës në qershor të vitit 1387. Ipeshkvi bënte të ditur me shkrim në zyrat përkatëse të Raguzës, se i falte kapelanit të tij, Pelegrinit, librat e tij kishtarë, një breviar dhe një manual dore (brevarium et suum manuale) si dhe shtratin mbi të cilin ai flinte pranë tij¹⁴. Ipeshkvi deklaronte se ky ishte vullneti i tij për shërbimet që kishte marrë nga kapelani i larpërmendur.

Klerikët kryenin shërbime të rëndësishme diplomatike në interes të komunave të vendit. Këta klerikë ishin në gjendje të paraqisnin kërkesat e tyre në gjuhën latine në Senatin e Venedikut dhe të diskutonin po në këtë gjuhë me autoritetet e larta të Venedikut. Ata kryenin po ashtu shërbime të veçanta diplomatike në favor të princërve të vendit me oborret e vendeve italiane dhe evropiane të kohës¹⁵.

Klerikë të tillë të shquar kishte edhe në Shas, edhe në zonën e Shkodrës në përgjithësi. Një i tillë ishte kleriku dom Nikolla nga fshati Samrisht. Ky klerik u dërgua nga Gjergji II Balsha më 1395 në Venedik, kur Shkodra ishte nën rrezikun e pushtimit osman. Dom Nikolla mbante titullin “profesor i teologjisë”.

Klerikët formoheshin në hapat e para në Raguzë dhe më tej shkoni në Perëndim në insitucione të veçanta formimi.

Në dhjetor të vitit 1364 burimet përmendin në Raguzë qytetarin Pervo. Ai ishte i biri i një banori të Shasit, që mbante emrin *Chier de*

¹³ Lidhur me historinë e qytetit shih: C.Jireček, *Skutari*, f. 119.

¹⁴ “Dominus Petrus episcopus Soacensis facit manifestum, quod ipse dat, tradit et donat presente more irrevocabili inter vivos, quod non possit revocari aliqua ingratitude uel offensa, domino Pelegrino capellano suo ob remunerationem servitorum ab eo receptorum suum brevarium et suum manuale et illum lectum munitum, in quo dormiebat dictus dominus Pelegrinus; promittens dictam donationem habere perpetuo firmam et gratam. *Div.Canc. 1387-1389 (A.Alb., II, 411)*.

¹⁵ Burimet bëjnë të ditur se Karl Topia dërgoi në Venedik ambasador të tij ipeshkvin e Vregos Johanin, kur donte t’i dorëzonte atyre Durrësin më 1386 për shkak të rrezikut osman, që kërcënonte tashmë principatën. Burimet po ashtu bëjnë të ditur se edhe Skënderbeu dërgonte kryepeshkvin e Durrësit Pal Engjëllin dhe ipeshkvin e Manastirit të Rotecit në Tivar në shërbimet urgjente diplomatike me Mbretërinë e Napolit, Republikën e Venedikut, Papatin dhe kancelari të tjera italiane të shek.XV.

Soacio. Pervo përpiqej të vendoste pranë mjeshtrit Johan de Cividato, i cili mbante titullin *magjistër në gramatikë*, nipin e tij Marinin. Sipas marrëveshjes mjeshtri Johan merrte përsipër që brenda tetë vjetëve t'i mësonte Marinin "*shkencën e gramatikës*". Marrëveshja midis palëve u prish për arsye që nuk thuhet, por pavarësisht nga ky fakt, dokumenti bën të ditur rrugën nëpër të cilën kalonte formimi i klerikëve të rinj nga Shasi¹⁶.

Një vend të rëndësishëm në klerin katolik të Shasit zinte ipeshkvi. Ky përfaqësonte komunën e Shasit në marrëdhëniet e saj të jashtme. Sipas statutit të Shkodrës, ipeshkvi kishte kompetenca të drejtpërdrejta të ushtronte kontrollin e tij mbi gjyqin kishtar. Dokumentat e vulosura prej tij ngjallnin besim dhe respekt të veçantë tek banorët.

Një pushtet të tillë të rëndësishëm kishte ipeshkvi në Shas. Më 25 maj 1368 burimet përmendin ipeshkvin e Shasit që ishte dërguar pranë papës Nikolla V nga Strazimiri I, Gjergji I, dhe Balsha II, për t'i kthyer ata në katolikë. Ipeshkvi i dërguar quhej Pjetër¹⁷.

Deri atëherë Balshajt kishin qenë ortodoksë. Kthimi në katolikë lidhej me përpjekjet e tyre për të gjetur mbështetje në Romë (Itali). Me kalimin në katolikë, Balshajt përpiqeshin të forconin sundimin e tyre në tokat shqiptare me besim katolik.

Më 29 janar 1369 Balshajt i shkruanin papës Urbanit V se kishin marrë nga ipeshkvi letrën e tij, që lejonte të bëhej konvertimi i kërkuar¹⁸ dhe premtonin se do të plotësonin kërkesat e duhura, në prani të peshkopëve Pjetër nga Shasi, Johanit nga Drishti, atit të krishterë të rendit të predikatorëve, Pjetrit, dhe qytetarit fisnik të Ulqinit, Peruezit (nobilis viri Peruosii civis Dulcinensis)¹⁹.

¹⁶ 1364, 9 dhjetor Raguzë, "Pervosi, djali i Chier de Soaço" vendos "pranë mjeshtrit Johan de Cividato, mjeshtër në gramatikë", nipin e tij Mariçe për të 8 vjet që t'i "mësojë atij shkencën e gramatikës" (*shlyer me vullnetin e palëve*); *Div.Canc.1364-1365 inserta Div.,Canc, 1435*, fol.102.

¹⁷ "venerabilis fratris nostri Petri episcopi Suaciensis" (A. Alb., II, 242); O.Schmitt, *vep. e për.*, f.190.

¹⁸ "litteras bullatas" (A. Alb., II, 253).

¹⁹ *Po aty*. Për t'i dhënë një vlerë të veçantë aktit të betimi të krishterë, Balshajt ndërhyjnë që ai të shkruhej nga ipeshkvi i Ulqinit dhe mbi këtë akt vuri "vullën e përbashkët" princ Strazimiri meqenëse, siç thuhet në dokument, ai nuk kishte me vete vullën e vet. Pas tij mbi të vunë vullën "pontifikale" edhe ipeshkvi i Shasit dhe i Drishtit. (A. Alb., II, 253).

Ky hap, në drejtim të kthimit në katolikë, pësoi një goditje të rëndë me daljen e rrezikut të pushtimit osman mbi principatën e tyre. Burimet njoftojnë se Gjergji I u detyrua më 1375 të mbante në Kosovë një sinod ortodoks me klerikët serbë të knjaz Lazarit²⁰.

Me fillimin e vërshimit osman në tokat shqiptare, situata u bë mjaft e vështirë për ipeshkvët katolikë të vendit . Burimet njoftojnë se ipeshkvët nuk qëndronin gjithmonë në komunat e tyre²¹.

Në shkurt të vitit 1384 ipeshkvi i Shasit ndodhej në Raguzë në një.gjëndje të vështirë ekonomike. Më 16 mars Rektori i Raguzës me këshillin e tij të vogël, kërkonte pëlqimin e Këshillit të madh për t'i dhënë këtij ipeshkvi një borxh prej 25 dukatë²². Nga dokumenti marrim vesh se ipeshkvi në fjalë kishte ardhur në Raguzë më 23 mars²³, pra gati një vit më parë.

Në fund të shek XIV qyteti ishte në rënie për shkak të ngjarjeve të vështira që kalonte vendi nga sulmet osmane²⁴. Kjo situatë u bë më e rëndë edhe për shkak të luftës, që shpërtheu në krahinën e Shkodrës, midis Balshës III dhe Sinjorisë në vitet 1403-1421.

Deri atëherë Sinjoria kishte pasur marrëdhënie të mira me Balshajt. Për shkak të turqve osmanë që arritën të pushtonin më 1393-1395 Shirgjin dhe një pjesë të Shkodrës, Balshajt i lëshuan Sinjorisë më 1396 Shkodrën dhe Drishtin dhe mbajtën për vete zotërimin mbi Ulqin dhe Tivarin.

Mirëpo më 1402 turqit u thyen në betejën e Ankarasë nga mongolët. Udhëheqësi i tyre Timur Lengu zuri rob në këtë betejë edhe sulltan Bajazitin I, i cili vdiq si rob pranë tij. Pas kësaj ngjarje, turqit osmanë nuk përbënin më rrezik për pushtimin e vendit. Perandoria Osmane u përfshi në luftëra të brendshme për pushtet midis djemve të

²⁰ O.Schmitt, *vep. e përm.*, f.190.

²¹ *Po aty*, f. 134.

²² Anno 1384, 16 februarii “prima pars est de dando libertatem domino rectori et minori consilio de dando ad XXV ducatos infra episcopo Petrucio de Soaço, ut maneat in Ragusio et sic in antea (?), et firmando ipsum secundum quod eis melius videbitur. Captum per ballotas XLIII” (A. Alb., II).

²³ “I thëni zoti ipeshkv erdhi në Raguzë më 22 mars” (A.Alb., II, *Reform 1382-1384*, fol. 224).

²⁴ O.Schmitt, *vep. e përm.*, Tiranë, 2007, f .96, shen. 3.

Bajazitit I. Në këtë situatë, Balsha III kërkoi largimin e Venedikut nga Shkodra dhe Drishti, dhe kthimin e këtyre qyteteve në zotërim të tij²⁵.

Për të realizuar këtë qëllim, Balsha III shpërtheu një sulm të armatosur kundër Drishtit dhe Shkodrës. Lufta në fillim shkoi mbarë për Balshën III, por më pas ajo anoi nga Venediku. Kështu më 1406 Sinjoria mundi t'i marrë Balshës jo vetëm Shkodrën dhe Drishtin, por edhe qytetin e Tivarit dhe të Ulqinit. Marin Karavello, kapedani i flotës veneciane të Adriatikut, që realizoi këtë aksion, bëri një marrëveshje me përfaqësuesit e Ulqinit dhe Tivarit, ku zotohej se do t'i qeveriste këto qytete duke respektuar statutet, zakonet dhe normat e tyre të vjetra. Në këtë kohë edhe Shasi kaloi nën Venedikun²⁶.

Në 18 maj 1406, ipeshkvi i Shasit paraqiti në Venedik disa kërkesa në emër të "komunitetit". Ai shprehte nevojën për fortifikimin e Shasit dhe rrethimin e tij me mure. Ipeshkvi bënte të ditur se ky qytet kishte qenë edhe më parë me mure dhe me fortifikim²⁷. Ai kërkonte të merreshin këto masa fortifikuese për shkak të turqve dhe zotërinjve të tjerë "tiranë", siç i quante ai Balshajt, që plaçkisnin dhe terrorizonin Shasin. Kur turqit, - thoshte ipeshkvi- kalonin në krahinën e tyre, ata kapnin banorët dhe i dërgonin në Turqi për t'i shitur si robër²⁸.

Ipeshkvi i kërkoi Sinjorisë të konfirmonte edhe kufijtë e komunës së Shasit sipas zakoneve të komunitetit²⁹.

Sinjoria përgjigjej se për këtë kërkesë do t'i shkruante kontit të Ulqinit, me qëllim që të informohej për kufijtë e tyre, duke kontrolluar "privilegjet, apo zakonet e vjetra". Rektori i saj, - thoshte Sinjoria - do të

²⁵ L.Malltezi, *Shkaqet e luftës së Balshës III kundër Republikës së Venedikut në 20 vjetët e parë të shek.XV*, në "Studime historike", nr. 2, 1980.

²⁶ "Pacta concessa Antibarensibus in acquisitione ipsius ciuitatis per Nobilem virum Marinum Karauello tunc capitaneum culfi et confirmata per nostrum dominum" *Acta Albaniae Veneta* (më tej: AAV), 1177; *A. Alb.*, II, 799; dhe "Infrascripta sunt pacta facta Dulcinensibus tempore acquisitionis eorum per Nobilem virum ser Marinum karauello tunc nostrum culphy generalem Capitaneum" AAV, 1178; *A. Alb.*, II, 770, 800.

²⁷ "Së pari, për kapitullin e parë dhe kërkesën e parë me të cilën luten që të mund të fortifikojnë dhe të murosin atë vënd sikundër ka qënë dikur" (AAV, 1187; *A. Alb.*, II, 798).

²⁸ Sinjoria përgjigjej se këtë kërkesë do t'ia kalonte për shqyrtim kontit, kapedanit të Shkodrës, me qëllim që të informohej si qëndronte kjo çështje dhe ç'duhej bërë për të ardhmen (*Po aty*).

²⁹ "Për kapitullin e dytë me të cilin kërkohen që të dënjojmë të konformojmë kufijtë sipas zakoneve të tyre" (*Po aty*).

respektonte gjithçka që do të rezultonte se ishte respektuar më parë prej saj.

Ipeshkvi, po ashtu, i kërkonte Sinjorisë që t'i konfirmonte të gjithë zotërimet, juridiksionet dhe zakonet³⁰.

Ipeshkvi bënte të ditur se këto “zotërime, juridiksione dhe zakone” i ishin konfirmuar ipeshkëve të kaluar të Shasit edhe nga zotërinj të tjerë paraardhës. Sinjoria, në përgjigjen e saj, thonte se për këtë do të komunikonte me qeveritarin e Shkodrës. Ai duhej ta informonte dhe sqaronte me qëllim që ajo (Sinjoria) të ishte në gjendje të vendoste siç do t'i dukej më mirë për këtë problem.

Ngjarjet që rodhën treguan se Sinjoria nuk e kishte të lehtë të likuidonte Balshën III, për shkak të lidhjeve të ngushta që kishte me zotërinj të fuqishëm të kohës. Një zotëri i tillë i fuqishëm ishte “kont Niketë Topia”. Burimet bëjnë të ditur se ai ishte “vjeherri i Balshës III”. Një zot tjetër i fuqishëm, mik i Balshajve, ishte despoti i Serbisë, Stefan Lazareviçi me të shoqen Mara.

Stefan Lazareviçi dhe Niketë Topia i kërkuan Sinjorisë të mirrej vesh më Balshën III, dhe me të emën e tij, Helenën, dhe t'i lëshonte atyre vende që ata të mund të jetonin me dinjitet, siç i takonin si zotër të vendit.³¹

Kërkesa të tilla paraqitën në Venedik edhe ambasadorët e Balshës III³².

Diskutimet midis palëve shkuan gjatë³³. Po përmendim këtu dy kërkesa të përfaqësuesve të Balshës III që bëjnë fjalë për Shasin.

³⁰ “kërkon që të dënjojmë t'i kofirmojmë atij ipeshkvi sipas zakonit të vjetër dhe sikundër që kanë qënë të gjithë ipeshkvitë e tjerë parardhës, të gjithë zotërimet (possessiones), juridiksionet dhe zakonet (consuetudines)” (*Po aty*).

³¹ “përfaqësuesi i zotit despot të Sklavisë dhe të tjerë, thotë që është mirë që zotërimi ynë të kujdeset për ushqimin e Balshës dhe nënës së thënë në mënyrë të tillë që të ketë arsye të respektojë çfarë na ka premtuar dhe të mos detyrohen nga nevoja të thejnë fjalën e dhënë dhe premtimet e tyre” (*AAV*, 1297).

³² “Meqenëse nga praktika që kemi pasur me ato përfaqësues të Shqipërisë kuptohet se ... nuk mund të ketë një marrëveshje të mirë dhe të qëndrueshme nëse zotërimi ynë nuk i jep Balshës dhe nënës së tij hirin në një formë të tillë që të jetojnë ndershmërisht” (*AAV*, 1294).

³³ Sinjoria deklaroi se pranonte t'i lëshonte Balshës III dhe nënës tij Budvën dhe Lusticën bashkë me kriporet që thuhej se i përkisnin Budvës si dhe një shpërblim vjetor prej 1000 dukatë në vit, siç i jepte dikur Sinjoria edhe të jatit të tij. Sinjoria urdhëronte njerëzit e vet se nëse Balsha nuk do të ishte i kënaqur nga ky shpërblim, ata mund t'ia grinin atë deri në 2000 dukatë ar. Në qoftë se do të binte

Njerëzit e Balshës III kërkuan që Sinjoria t'i jepte zotit të tyre jo 1000, por 1500 dukatë si shpërblim vjetor dhe po ashtu t'i jepte atij qytetin e Budvës me të gjithë përkatëritë.

Më këtë rast njerëzit e Balshës III i kërkuan Sinjorisë t'i lëshonte zotit të tyre, edhe fshatrat Poprat, Shas, Rotec dhe Krajna.

Lidhur me këto fshatra Sinjoria pati sinjalizime të ndryshme nga njerëzit e vet. Disa kishin njoftuar se këto fshatra ishin në përkatësi të Ulqinit, disa të tjerë kishin sinjalizuar se ishin në përkatësi të Tivarit dhe disa të tjerë akoma e kishin sinjalizuar se këto fshatra ishin “juridiksione dhe vende më vete”³⁴. Sinjoria kishte marrë ndërkohë edhe një informacion tjetër të rëndësishëm nga njerëzit e vet³⁵.

Këto fshatra, siç bënin të ditur, ishin në mes të Ulqinit dhe Tivarit. Ato ishin në një pozicion të tillë të favorshëm strategjik që po t'i kishte Balsha, atëhere ai mund të cenonte fare lehtë territorin e Ulqinit dhe të Tivarit.

Pas këtij informacioni, Sinjoria arriti në konkluzionin se do të ishte “rrezik i madh”, në se këto vende do të binin në dorë të Balshës³⁶. Ajo vendosi t'u thuhej përfaqësuesve të tij, se nuk mund t'ia lëshonte fshatrat

dakort me këto premtime, atëhere të vihej në marrëveshje që Balsha dhe nëna e tij, fëmijët dhe trashëgimtarët e tij, të deklaroheshin si miq dhe besnikë të Republikës së Venedikut duke marrë përsipër në këtë rast edhe detyrimet përkatëse siç ishin të caktuara në zakonet e kohës.

Sinjoria kërkonte me këtë që edhe Niketë Topia dhe despoti i Serbisë më të shoqën e tij Mara të mbanin anën e Venedikut në rast se Balsha do të prishte këtë marrëveshje. Mirëpo siç treguan bisedimet e vitit 1407, Balsha nuk ra dakord me këto premtime. Në pamundësi për të vijuar luftën, Sinjoria u detyrua t'u thonte përfaqësuesve të “Shqipërisë” (Albanie) se ishte gati t'i lëshonte atij Budvën, Tivarin dhe Gentën e Sipërme siç i mbante më parë si dhe t'i jepte një provision prej 1000 dukatë, siç ia jepnin babait të tij. Si “shpërblim” Sinjoria kërkonte që Balsha të ishte fisnik i saj sikundër kishte qenë i ati i tij, të trajtonte mirë njerëzit e Budvës dhe Tivarit, t'i thoshte turqve së është në paqë me Sinjorinë. Sipas këtij propozimi, Sinjoria do të kishte si zotërim të vet “Shkodrën, Drishtin, Ulqinin” dhe “vende të tjera përveç Budvës dhe Tivarit”, të cilat i kalonin Balshës III. Sinjoria kërkonte që despoti dhe zonja Marë dhe Niketë Topia të betoheshin dhe të premtonin të mbanin anën e Sinjorisë, nëse Balsha do të shkelte këtë marrëveshje dhe ta detyronin atë dhe nënën e tij të shlyenin dëmet që mund të bënin (AAV, 1297).

³⁴ “que uillacia siue paesia, aliqui dicunt esse de pertinentij dulcigni uel Antiuari, aliqui dicunt quod non, sed jurisdictiones et paesia da per se” (AAV, 1297).

³⁵ “nostris subditis e fidelibus” (AAV, 1297).

³⁶ AAV, 1297.

e lartpërmendura, por pranonte t'i jepte atij Buduen me përkatëritë, Lusticën dhe kriporet, si dhe dymijë dukatë nga të ardhurat e atjeshme.

Nëse përfaqësuesit e Balshës III nuk do të pranonin, Sinjoria urdhëronte njerëzit e saj t'i jepnin Balshës fshatrat që kërkonte, d.m.th. 12 fshatrat që mbante Petro Menguzi, 9 fshatra që mbante Jurg Tupi, si dhe Koplkun, Kalldrunin, Chodegera-n (Chodegora-n(?), Gripën, Balëzën, ndërsa Sinjoria të mbante Shkodrën, Drishtin. Brenda këtyre kufijve Sinjoria pranonte t'i lëshonte Balshës III edhe fshatrat që kërkonin ambasadorët e tij, d.m.th. Popratin, Shatin (Soaco) Rotezin dhe Krajnën (Crayna). Sinjoria kërkonte gjithashtu që t'i mbeteshin asaj të gjitha fshatrat e tjera në malësi nga Pastroviqët deri në lumin e Bunës, ndërsa Pastroviqi vetë t'i mbetej Balshës III.

Sinjoria urdhëronte që nëse do të binin dakord atëhere palët të bënin midis tyre marrëveshje (fiat conclusio in bona gratia). Sinjoria urdhëronte në këtë rast, që të merrej edhe vendimi për të zgjedhur në këshill dy provisorë solemnë që të niseshin në vendet e Balshës për të bërë këtë marrëveshje. Në datën 15 tetor u mor vendimi që dogja t'u bënte të ditur ambasadorëve të Balshës vendimin që kishte marrë Sinjoria.

Marrëdhëniet e Balshës III me Sinjorinë u shoqëruan me përplasje të armatosur midis dy palëve edhe në vitet 1413-1417. Burimet njoftojnë se këto vite qenë mjaft të vështira për popullsinë. Në këto vite u dogjën dhe u prishën arat, ullishtet, dhe vreshtat; u dogjën dhe u shkatërruan fshatra të tëra. Uria bëri kërdrinë mbi popullsinë e qyteteve.

Këto pasoja ranë edhe mbi Shasin që kishte mbetur nën Sinjorinë.

Ne kemi rast ta marrim vesh qartë këtë në prill të vitit 1443 nga një kërkesë që i bëri Sinjorisë ipeshkvi i Shasit. Kjo kërkesë u bë kur Sinjoria kishte marrë më 1443, Tivarin.

Peshkopi i bënte të ditur Sinjorisë se në këto ngjarje, ai kishte mbajtur një qëndrim të hapur politik në mbështetje të saj³⁷. Për këtë

³⁷ Në konfliktet e Sinjorisë me fisnikët shqiptarë sidomos me Balshën III, jo të gjithë klerikët mbajtën anën e saj. Burimet përmendin si "tradhëtarë" të Venedikut *don Dhimitër Paborin*. Sinjoria vepronte mbi klerikët kryengritës duke i konfiskuar pronat, të cilat ua kalonte të tjerëve për shfrytëzim. Kadastra veneciane e vitit 1416/1417 shënon se *don Dhimitër Pabori* kishte pasur në "qytetin e Shkodrës", "një shtëpi pjesërisht me mur e pjesërisht me dërrasa me mbulesë dërrasash" (2/b). Një kryengritës tjetër kishte qenë *peshkop Progani*. Kadastra përmend "një tokë që më parë ka qenë boshe" që kishte qenë e *peshkop Proganit*. Këtë Sinjoria ia kishte kaluar "Nerit" nga Ravena. Ky kishte ndërtuar mbi këtë tokë

shërbim, ipeshkvi kërkonte shtegun e shën Theodorit. Ipeshkvi thoshte se ky kalim i takonte juridikisht manastirit të tij³⁸.

Ipeshkvi bënte të ditur shërbimet e tij në favor të Venedikut. Ai deklaronte se kishte luajtur një rol të rëndësishëm, kur Sinjoria ishte përpjekur të merrte Drishtin. Ipeshkvi vinte në dukje se në këtë kohë, ai kishte kthyer në favor të Sinjorisë fisin e fuqishëm të Popratit dhe popullsinë e disa vendeve të tjera.

Duke mbajtur këtë qëndrim, ai kishte ekspozuar veten si person besnik ndaj Sinjorisë dhe armiqtë, në shenjë hakmarrje, i kishin hedhur në erë pasurinë dhe kishin djegur edhe vetë manastirin.

Sinjoria u sinjalizua nga rektori aktual i Shkodrës dhe qeveritarët paraardhës, se ipeshkvi thoshte të vërtetën, por ata bënë të ditur se çështja e shtegut, që ai kërkonte, qëndronte ndryshe nga sa thoshte ai.

Ky shteg, sipas tyre, kishte qenë i Sinjorisë dhe jo i manastirit prandaj Sinjoria nuk duhej t'ia dorëzonte atij, por ipeshkvin duhej ta ndihmonte kohë pas kohe si besnik të saj.

një shtëpi dhe për këtë tokë paguante tre perperë në vit (3/a). *Peshkop Progani* kishte pasur edhe pronë (arë) toke, e cila edhe kjo ishte konfiskuar dhe dhënë me qera nga Sinjoria. Kadastra përmend edhe “një arë” tjetër të “tradhëtarit peshkop Proganit”, të cilën Sinjoria ia kishte lëshuar Gjijn Lubanit. Kadastra përmend dom Pjero Balenin, i cili kishte marrë “një gjysëm vreshti” që kishte qenë i “tradhëtarit” dom Pjero Bojçinit. Dom Pjero duhet të paguajë për këtë “çdo vit të katërtën e të ardhurave të gjysmës së vreshtit” (29/b).

³⁸ 1443 IV 11 Të urtët e urdhërave. Meqënëse në praninë tonë u paraqit ati i nderuar zoti Pal, Episkopi i Shasit, duke thënë se ishte përpjekur për zotërimin tonë për marrjen e Drishtit dhe vendeve të Zetës duke tërhequr pamaliojtë dhe një vend të madh në bindje të tillë (pranë Venedikut), aq sa u shkatërrua duke u konsideruar nga armiqtë si një njeri shumë besnik (ndaj nesh) duke humbur kështu të gjithë pasuritë e tij të lëvizshme, si dhe iu dogj shtëpia dhe manastiri. Për shkak të punëve të tij shumë të mira dhe për besnikërinë e tij, kërkon kalimin e shën Theodorit që i jep Komunës 24 hiperperë në vit duke thënë se ai ka qenë i manastirit të tij... Rektoret që kanë qenë në Shkodër këshillojnë që kalimi i kërkuar prej tij, duhet të na jepet ne, sepse fitimi gjithmonë ka qenë nxjerrë nga komuna, por atij (ipeshkvit) gjithsesi duhet t'i jepet ndihmë kohë pas kohe. Shtrohet për vendim që t'i thuhet ipeshkvit të sipërthënë se: ne çmojmë punën e tij dhe jemi të gatshëm t'i bëjmë qejfin në çdo gjë të mundshme dhe të ndershme, për shkak të sjelljes së mirë që na u bë e qartë nga rektorët, por kalimi i shën Teodorit, siç kuptojmë, ka qenë në duart e zotërimit tonë dhe jo të kishës së tij, prandaj nuk na duket me vend t'ia japim atij. Por që të kuptojë se me atë që mundemi, duam t'i vimë në ndihmë dhe t'i bëjmë qejfin, do të urdhërojmë kontin tonë të Shkodrës që për katër muajt e ardhshëm...duhet t'i japë nga tetë dukatë në muaj nga të ardhurat e dhomës sonë të Shkodrës (*Po aty*).

Sinjoria, urdhëroi rektorin e Shkodrës t'i bënte të ditur ipeshkvit, se do t'i jepte për katër muaj nga tetë dukatë derisa ai të rindëronte manastirin, ndërsa përse i përkiste shtegut, ajo nuk mund t'ia jepte atij, sepse shtegu nuk kishte qënë kurrë pronë e manastirit³⁹.

Pas viteve 1443 sundimi venedikas në Tivar u forcua.

Sinjoria mundi t'i mbante zotërimet e veta në Shqipëri duke tërhequr pas vetes fisnikë dhe njerëz të shquar, duke u dhënë atyre prona dhe privilegje të tjera. Prona të tilla Sinjoria lëshoi edhe në Shas. Burimet sinjalizojnë se Sinjoria u dha toka në Shas si "pronia", Theodorit dhe Dominikut nga Tivari⁴⁰.

Pas vitit 1463 Sinjoria u përfshi drejtpërdrejt në luftë me turqit osmanë. Ajo hyri me këtë rast në lidhje me Skënderbeun që prej disa dekadash luftonte në krye të shqiptarëve kundër tyre.

Gjatë këtyre viteve duhet menduar se banorët e Shasit ishin pjesëmarrës në këtë luftë. Por Shasi tani nuk ishte më një qytet i rëndësishëm si më parë. Koha kishte sjellë ngjarje të rënda për vendin. Në zjarrin e luftës që përfshiu Shqipërinë në shekullin XV me Balshajt dhe më pas me turqit, shumë banorë kishin braktisur qytetin.

Pas vdekjes së Skënderbeut, në Venedik u paraqitën njerëz që e hiqnin veten si pasardhës të Balshajve. Këta kërkuan nga Sinjoria t'u konfirmonte tokat që u kishte rrëmbyer Skënderbeu kohë më parë. Një nga këto ishte Johan Balsha. Ai pretendonte të shtinte në dorë toka nga Shasi deri në afërsi të Durrësit (1469)⁴¹.

Në këtë kohë Shasi ishte një fshat i thjeshtë. Konti kapedan i Shkodrës Francesk Kuirini ia kishte lëshuar atë si pronjë që më 29 maj 1444 përkrahësve të Venedikut nga Tivari, Domenikut dhe Teodorit⁴².

³⁹ AAV, XVIII, 4803.

⁴⁰ ASV *Avogaria de Comun. Lettere ai Rettori*, fletorja 2 146 rv.; O.Schmitt, *vep. e për.*, 468.

⁴¹ *Po aty, Actes* Nr. 67-69.

⁴² *Archivio di Senato, Venetia. Avogaria de Comun. Lettere ai Rettori* fletore 2 146r 5.III.1456. Letër e Avogaria de Comun drejtuar kontit Andrea Venier i Shkodrës: "Fuit nobis ostentum per patentes litteras tempore regimnis viri nobilis ser Franc. Quirinio Comitit et Capitanei Scutari sub 1444 die 29 Marcij et per confirmationem siue terminationem confirmantionis de 1448 die xij februarj. Per dictos. dominos. Oratores et Provisores in partibus Albaniae factam laudano et confirmando illas concessionis factas Theodoro de Dominico de Antibarro de provisionibus positit in Suacio datit sibi in dotam pro nato Marossa et Andream eius filium cum uxore sua nomine Marco et tamen ut parte domini Theodori coram

Komuna e Shasit, “Suacium” i famshëm, në vitin 1470 njihej vetëm si “fshat ose vendbanim”⁴³. Shasi vazhdoi të ishte nën Venedikun deri në rënien e Shkodrës më 1479. Pas kësaj date, Shasi kaloi nën sundimin osman që zgjati mbi katër shekuj.

S u m m a r y

SHASI (SUACIUM, SVACIUM, SUVACIUM, SOACIUM, SVAÇ) DURING THE 14TH AND 15TH CENTURIES

Shasi is first mentioned in year 1067. During the middle ages it was under the Byzantines and later on under the Serbs invasion. Shasi based its economical and social development in its own “uses” and traditions. Important roles in social-economical and political life of Shasi have played the bishops. During the second half of the 14th century Shasi passed under the control of Balshaj. With the beginning of the ottoman attacks for the invasion of the Albanian lands Shasi started to decline economically. It declined even more due to the war that broke between Ballsha III and the Signoria during 1403-1421. The bishop of Shasi took a clear position in support of Signoria. In 1443 he turned in the favour of Signoria the powerful tribe of Poprati as well as many inhabitants of other villages. As an act of vengeance the adversary burned down the monastery of the bishop and seized the incomes. After 1463 Signoria was involved in the war with the ottoman Turks but Shasi was not an important community any more and many of its inhabitants had abandoned the city. The Earl of Shkodra had conceded it as a *pronjie* in favour of two citizens in May 1444. Later on Shasi was occupied by the ottoman Turks.

Nowadays Shasi is an abandoned and deserted city of church ruins and walls.

nobis gravatum est quidam Albanenses occupant sibi de dictis territorijs et petijt sibi prouidere”.

⁴³ *Archivio di Senato, Venetia. Senato Mar Reg. 9 41v* “villam seu locum Suacij”.